

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC/Divizioni Penal**, gjyqtari i vetëm gjykues Ilir Rashkaj, me procesmbajtësin Shani Canziba, sekretar juridik i kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit S. M. nga fshati R., Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.530/2016 të datës 29.09.2016, në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datën 20.07.2018, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Dëshire Jusaj të akuzuarit dhe përfaqësuesit të të dëmtuarës KEDS L. M., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I akuzuari,

**S. M.**, nga i ati Sh. dhe e ëma Sh., e lindur H., i lindur me datën ..., në fshatin R., Komuna e Rahovecit, ku edhe tani jeton, me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën fillore, me profesion bujk, i martuar, i ati i katër (4) fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar,

### ËSHTË FAJTOR

**Sepse**, prej datës së pavërtetuar e deri me datën 21.05.2015, në shtëpinë e tij në fshatin R., Komuna e Rahovecit, me qëllim që vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike në atë mënyrë që pa njehsor elektrik ka bërë lidhjen direkt në rrjetin elektrik, me çka ka penguar kështu regjistrimin e energjisë së shpenzuar elektrike, gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar të KEDS – Distrikti në Prishtinë, me rastin e kryerjes së kontrollës, me ç’rast të dëmtuarës KEDS – Divizioni i Rrjetit – Distrikti në Gjakovë i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 267.97 €.

- Me këtë ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 4, 6, 7, 17, 41, 42, 49 par.1 pika 1.1, 50, 51, 52 dhe 73 të KPRK-së, si dhe nenit 323 të Kodit të Procedurës Penale, të njëjtit i shqipton:

### DËNIM ME KUSHT

Ashtu që e gjykon me dënim me gjobë në shumën prej njëqind (100) € dhe dënim burgimi në kohëzgjatje prej njëqindnjëzet (120) ditëve, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.

Obligohet i akuzuari, që në emër të shpenzimeve të procedurës penale - paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

E dëmtuara KEDS–Distrikti në Gjakovë, udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest civil.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzën, PP.nr.530/2016 të datës 29.09.2016, me të cilën e ka akuzuar të pandehurin S. M. nga fshati R., Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, dhe ka propozuar që pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe vlerësimit të provave i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata, me datën 20.07.2018, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, dhe kanë marrë pjesë Prokurori i Shtetit Dëshire Jusaj, i akuzuari S. M. dhe L. M., përf. i KEDS-it, me ç'rast Prokurori i Shtetit pas leximit dhe analizimit të aktakuzës ka qëndruar në tërësi pranë saj.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ka dhënë mundësinë që të pranojë ose të mos e pranojë fajësinë. Pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë gjykata ia ka tërhequr vërejtjen lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale që i ngarkohet. Gjykata, gjithashtu e ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit, sa i përket pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit, dhe të njëjtit kanë qenë të mendimit se pranimi i fajësisë është plotësisht i vullnetshëm dhe mbështetet në provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Duke pasur parasysh të gjitha këto që u thanë më lartë, e meqenëse janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 248 par. 1 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe nuk është lëshuar në procedurën e provave e as në fjalën përfundimtare, po ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktakuzës.

Gjykata ka gjetur se i akuzuari ka kryer veprën vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, dhe gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte e përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë: procesverbali me nr.0403921 i dt.21.05.2015, fatura mbi dëmin e shkaktuar DGJ15HP04986 e dt.12.06.2015 të lëshuar nga sektori i faturimit – KEDS – Divizioni i furnizimit në Gjakovë, fatura me nr.9301 të dt.12.06.2015, si dhe foto dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës, janë prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Prandaj, në bazë të këtyre provave dhe vet pranimit të fajësisë, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 73 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të të akuzuarit, pranimin e fajësisë, pendimin për rastin që ka ndodhur, këtë e ka bërë pasi që në atë kohë e kam ndërtuar shtëpinë e re, mirëpo nuk e kam pasur të vendosur njësoarin e rrymës, nuk e kam ditur që kjo përbën vepër penale dhe nuk i ka menduar pasojat, se është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, premtimin para gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryen vepra të tjera penale, është i pa punë, mbajtës i vetëm i familjes prej gjashtë anëtarëve, si dhe gjendjen e varfër ekonomike, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti.

Andaj, gjykata ka ardhur në përfundim se me shqiptimin e dënimit me kusht, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit konform nenit 41 par. 1 dhe 2 të KPK-së, dhe ky dënim është në proporcion me peshën e veprës, me sjelljen dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor konform nenit 450 paragrafi 1 dhe 2 nënpar.2.6 të KPPK-së.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontest civil, sipas nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 365 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC**  
**- Divizioni Penal -**  
**P.nr.355/2016, me datën 20.07.2018**

**Sekretari juridik,**  
Shani Canziba

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
Ilir Rashkaj

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.